



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare



520 / 07.07.2020

Në vështrim të nenit 2 paragrafi 1 dhe nenit 15 paragrafi 1, të Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Hafir Shala" Nr.12-030-16596, i datës 27.05.2020 në Drenas, nenit 8 paragrafi 1 dhe 2, neni 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Hafir Shala" në Drenas, me datë 07.07.2020, shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e shtatë (7) vendeve të lira pune për Doktor të Mjekësisë dhe tre (3) vende të lira pune për Infermierë, me kohë të pacaktuar

I. Titulli i vendit të punës:

1. **Shtatë (7) Doktor të Mjekësisë, në K.P.SH.** – Drenas i përgjigjen menaxherit, Drejtorit të QKMF-së, të cilët sipas nevojave të punëdhënësit (bazuar në Ligjin e Punës neni 17 dhe në UA nr. 08/2017)
2. **Tre (3), Infermier/e me drejtime adekuate profesionale,** të Infermierisë së përgjithshme, në KPSH-QKMF, në sektorin e emergjencës mjekësore, sipas nevojave të punëdhënësit (bazuar në Ligjin e Punës neni 17 dhe në UA nr. 08/2017)
3. **Përshkrimi i detyrave të punës:**
 - 1) Punët dhe detyrat e punës të Doktorit Familjarë në KPSH: ofrimi i shërbimeve shëndetësore mbështetur në profesionalizëm, të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve pa dallime, respektim të etikës mjekësore humanizmit dhe respektimin e normave ligjore, i gatshëm të punojë në ndërrime nate – trajtime emergjente e urgjente, të sistemohet punë ekipore edhe punë tjera profesionale të kërkuara nga eprori.
 - 2) Punët dhe detyrat e infermierisë në KPSH: përgjithësisht ofron shërbime (përkujdesje) shëndetësore qytetarëve pa asnjë dallim në respektim të ligjit. Bënë triazhe dhe shërbime shëndetësore, dhënie terapishë i.m. i.v. inf, zbaton procedurat e reanimimit - antoschokut etj., duke përfshi edhe përkujdesje profesionale të shtatzënave, përgatit klientët për vizitë adekuate, punë në ndërrime, edukon dhe këshillon pacientët,

bënë sterilizimin e instrumenteve kirurgjike, përpunimin e plagëve edhe punë tjera të kërkuara nga eprori, punë ekipore.

- II. Pozita:** 1) Doktor i Mjekësisë, **Titulli i punës:** H-27; **Grada:**565
2) Infermier , **Titulli i punës:** H-68; **Grada:**377

Kushtet dhe kriteret:

1. Doktor i mjekësisë

- a. Diploma e fakultetit të mjekësisë e notorizuar
- b. Licenca e punës e lëshuar nga M SH ose OMK
- c. Letërnjoftimi , kopje
- d. Çertifikata që nuk është nën hetime lëshuar nga Gjykata
- e. Çertifikata e shëndetësore , pas kryerjes së intervistimit, nese nuk sillet me kohë të caktuar para lidhjes së kontratës vje në konsiderim kandidati i radhës

2. Infermierë

- a. Diploma (Bachelor (BSc) në Infermieri, shkolla e mesme e mjekësisë së përgjithshme) e notorizuar
- b. Licenca e punës e lëshuar nga M SH ose OIK
- c. Letërnjoftimi , kopje
- d. Çertifikata që nuk është nën hetime lëshuar nga Gjykata
- e. Çertifikata e shëndetësore , pas kryerjes së intervistimit, nese nuk sillet me kohë të caktuar para lidhjes së kontratës vje në konsiderim kandidati i radhës

III. Orari i punës: 40 orë në javë.

IV. Kontrata e punës: me kohë të pacaktuar.

V. Afati i konkursit është pesëmbëdhjete (15) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit.

Udhëzim: Të gjithë kandidatët-aplikantët mund të aplikojnë sipas afatit të lartshënuar, aplikacionet merren në objektin e QKMF-së “Dr Hafir Shala” në Drenasi (aplikacionit mund t’i bashkangjitet edhe CV-ja personale), Departamenti i Administratës – Burimet njerëzore, dhe t’i dorëzojnë në po të njëjtin vend. Dokumentacionet e pa kompletuara dhe ato të arritura pas afatit nuk do të shqyrtohen, procesi i rekrutimit të kandidatëve do të bëhet përmes testit me shkrim dhe intervistës gojore, informimi do të bëhet me kohë përmes ëeb faqes së Komunës së Drenasit, telefonit apo e-mailit të kandidatëve (e-maili i kandidatëve dhe nr. telefonit duhet patjetër të shënohet në aplikacion ose CV) si dhe njoftimit në tabelën e shpalljeve të QKMF-së Drenas.

Drejtori i QKMF-së

Dr. Ismet Bogiqi

